



Prishtinë, 23 qershor 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1252_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtritshme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve, dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin në parcelën ngastrada kadastrave Nr. 0223K-1 ZK Gjakovë, me kapacitet të instaluar prej **10 kW** në Komunën e Gjakovës, të datës 14.05.2020 me nr. prot. 205/20 të aplikuesit "GELI" SH.P.K., me adresë: rruga Skënderbeu, Komuna Gjakovë, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur më 23 qershor 2020 nxori këtë:

V E N D I M

PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. APROVOHET** - kërkesa e aplikuesit "GELI" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin e ndërtuar sipas Lejes Ndërtimore Nr. 07/351/02-27052 të dt. 16.07.2019 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizmit dhe Mbrojtje të Mjedisit, në parcelën ngastrada kadastrave Nr. 0223-1K ZK Gjakovë, me kapacitet të instaluar prej **10 kW** që do të vendosen mbi objekt, në Komunën e Gjakovës.
- II. OBLIGOHET** – aplikuesi "GELI" SH.P.K., me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DGJ- 9048741 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtroj kërkesë në KEDS SH.A., për pranimit teknik të objektit energjetik.
- III.** ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV.** Aplikuesi "GELI" SH.P.K., do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.


Arsyetim



- ZRRE, me datë 14.05.2020 nga aplikuesi "GELI" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në parcelën ngastra kadastrave Nr. 0223-1K ZK Gjakovë, me kapacitet të instaluar prej **10 kW** shifra e konsumatorit DGJ- 9048741 që do të vendosen mbi objekt, në Komunën e Rahovecit.
 - Aplikuesi, s'bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergjetik Nr. 2854 të datës 15.04.2020 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Përgjigjes Nr. 07-353/01-9501 të datës 13.05.2020 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjakovës.
 - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit "GELI" SH.P.K., dhe dëshmime të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike në objektin parcelën ngastra kadastrave Nr. 0223-1K ZK Gjakovë, me kapacitet të instaluar prej **10 kW** që do të vendosen mbi objekt, në Komunën e Gjakovës, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rusniti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Gjakovës,
- KEDS SH.A., dhe
- Arkivit të ZRRE-së.